

Analizë e shkurtër mbi mospërputhjen e arsimit dhe profesionit në Kosovë



Analizë e shkurtër mbi mospërputhjen e arsimit dhe profesionit në Kosovë

Prill 2020

Përmbajtja

Hyrje	4
Struktura e mospërputhjes horizontale në Kosovë	5
Çfarë përcakton mospërputhjen në mes arsimit dhe profesionit?	8
Dallimet gjinore në arsim dhe profesione	9
Përfundime dhe rekomandime	12
Anekset	14

Hyrje

Një ndër faktorët më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi është shfrytëzimi i duhur i burimeve njerëzore. Kjo nënkupton edhe orientimin e fuqisë punëtore në profesione të përshtatshme. Në Kosovë ekziston një hendek në mes të nevojave të tregut të punës dhe të kuadrove që dalin nga institucionet arsimore. Si pasojë, numri i individëve që përballen me mospërputhshmëri mes arsimimit dhe profesionit është tepër i madh.

Kjo mospërputhje nënkupton situatën kur kualifikimi i marrë nga një shkollë apo universitet nuk i përshtatet kualifikimeve të kërkuara nga një punëdhënës/e për punën që punëtori/ja bën. Mospërputhja mund të jetë vertikale – ku niveli i arsimit është më i ulët ose më i lartë se sa kërkohet për ta kryer një punë, apo horizontale – ku fusha e arsimit nuk ndërlidhet me punën që individët janë duke bërë.¹ Fokusi i këtij studimi është vetëm në mospërputhjen horizontale.

Disa nga faktorët që mund të kenë ndikim në mospërputhjen horizontale janë gjinia, mosha, statusi martesor, vendbanimi, etnia, fusha dhe niveli i arsimit, si dhe vetë industria e profesionit. Për më tepër, në fusha të caktuara arsimore e profesionale, dallimet gjinore në tregun e punës mund të kenë ndikim më të madh në mospërputhje, ku me dallime gjinore nënkuptohet shpërndarja jo e barabartë e punëtorëve burra dhe gra. Në nivel botëror, gratë përqëndrohen në sektorë me produktivitet të ulët, kurse brenda sektorëve, në industri me prodhimtari të ulët.²

Në këtë hulumtim, Instituti GAP analizon mospërputhjen e perceptuar të individëve në mes fushës së arsimit dhe asaj të punës, me një fokus në ndarjen strukturore të profesioneve sipas gjinisë. Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se gjinia, mosha, dhe vendbanimi përcaktojnë mospërputhjen horizontale si faktorë demografikë. Poashtu, problemi i mospërputhjes rrjedhë si pasojë e dallimeve më thelbësore të industrive profesionale dhe fushave arsimore. Rast i veçantë janë gratë që kanë përfunduar fusha të caktuara arsimit si inxhinieri apo drejtësi apo që punojnë në industri të caktuara si bujqësi, prodhim, dhe tregti të cilat përballen me mospërputhje më të madhe se burrat në ato fusha dhe industri. Gjithashtu, ky studim paraqet ndarjet sektoriale në punësim dhe arsimim të burrave dhe grave, ku shihet se burrat për dallim prej grave punësohen në industritë më produktive të ekonomisë, dhe se burrat dhe gratë ndjekin fusha arsimore historikisht të dominuara nga ta – burrat në inxhinieri, e gratë në edukim dhe shëndetësi. Si rrjedhojë, Instituti GAP rekomandon që të informohen studentët e tanishëm për mundësitë e punësimit në fushat e tyre pas shkollimit, dhe të ofrohen trajnime pas-universitare në bazë të kërkesave që burojnë nga tregu i punës me qëllim të përditësimit të njohurive të punëkërkuesëve të diplomuar. Poashtu, me qëllim për rritje të barazisë gjinore në sektorët më produktiv të ekonomisë së Kosovës dhe thyerjes së stereotipeve profesionale në tregun e punës, të informohen nxënësit në përgjithësi e sidomos vajzat, për profesione në sektorët ekonomik më produktiv dhe mbi profesione që historikisht kanë qenë të parapara për burra respektivisht gra.

¹ International Labour Office, 'Skills Mismatch in Europe: Statistics Brief,' (Geneva: ILO, 2014), 7. Burimi: <https://bit.ly/374NXrP>

² Smita Das and Aphichoke Kotikula, 'Gender-Based Employment Segregation : Understanding Causes and Policy Interventions' (The World Bank, 1 Janar 2019). Burimi: <http://bit.ly/38kF1Q9>

Struktura e mospërptuhjes horizontale në Kosovë

Me qëllim të identifikimit të përcaktuesve të mospërptuhjes horizontale tek popullsia e Kosovës, ky raport është mbështetur në të dhënat e prodhuara nga anketa e Korporatës së Fondationit të Mijëvjeçarit “Forca e Punës e Kosovës dhe Studimi i Përdorimit të Kohës.”³ Kjo anketë kishte për qëllim mbledhjen e informatave strukturore të fuqisë punëtore të Kosovës, sikurse që janë niveli i punësimit formal dhe jo-formal, ndërlidhjet në mes të fushës së arsimit dhe asaj të punësimit, si dhe arsytet e mospunësimit.⁴ Anketa është realizuar gjatë periudhës 31 Mars 2017 - 4 Gusht 2017.⁵


Analiza e Institutit GAP në bazë të këtyre të dhënave gjen se 54% e të anketuarve përballen me mospërptuhje horizontale. Struktura e kësaj mospërptuhjeje identifikohet tutje në bazë të karakteristikave të ndryshme demografike, arsimore, dhe industriale të të anketuarve. Rezultatet e analizës në Figurën 1 tregojnë se 61% e burrave në të dhënat e analizuara kanë mospërptuhje horizontale, gjë që ekziston vetëm te 39% e grave. Më tutje, shihet se beqarët kanë më shumë mospërptuhje horizontale (70%) se sa individët e martuar (48%), ata të divorcuar (46%), apo të ve (46%). Ky rezultat mund të jetë për shkak se beqarët mund të jenë në një fazë jetësore ku hasin më shumë jostabilitet profesional se sa individët me një status tjetër martesor. Një gjë e ngjashme duket edhe nëse i ndajmë të anketuarit në bazë të grupmoshës, ku 72% të individëve që janë prej 15 deri në 29 vjet kanë mospërptuhje horizontale, gjë që ulet gjatë jetës së një individi. Trendi i moshës mund të shpjegohet logjikisht ku mospërptuhja horizontale bie për shkak që individët më të moshuar kanë kaluar më gjatë në treg të punës dhe kanë më shumë stabilitet profesional. Sa i përket etnisë, individët që iu përkasin etnive jo-shqiptare nuk kanë dallime të mëdha të mospërptuhjes horizontale në krahasim me shqiptarët, gjë që tregon që etnia nuk luan rol të madh.

3 H. Siddiqui, A. Gashi, J. Higgins, B. Dasgupta, M. Pucilowski, ‘MCC Kosovo Labor Force and Time Use Study (LFTUS),’ DDI-MCC-KOS-LFTUS-2017-v01, 2017 Arlington, VA: Social Impact Inc. www.socialimpact.com

4 Anketa e përpiluar nga Social Impact Inc. dhe e ekzekutuar nga IDRA Research and Consulting kishte për njësi të të dhënave individët mbi 15 vjet që janë pjesë e një ekonomie familjare në 7 rajone, 854 qarqe regjis-truese, dhe 8540 ekonomi familjare në Kosovë me numër total të të anketuarve 11,682.

5 Edhe pse Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon të dhëna për fuqinë punëtore të Kosovës që nga viti 2001, ASK nuk ofron të dhëna të hapura të fuqisë punëtore në bazë individuale, si dhe të perceptimit individual të mospërptuhjes horizontale, gjë që do ta vështirësonte një analizë të kësaj. Poashtu, si pasojë e mospërditësimit të të dhënave individuale nga ASK, kjo analizë mbështetet në të dhëna më të hershme të vitit 2017, e jo në vite që mund të ishin më relevante gjatë përpilimit të kësaj analize. Prandaj, për analizën e përcaktuesve të mospërptuhjes horizontale individuale, ky studim mbështetet në të dhëna nga Korporata e Fondationit të Mijëvjeçarit, ndërsa për informata të agreguara në të dhënat e ASK.

Figura 1. Përputhja e fushës së arsimit dhe profesionit të të anketuarit/at në bazë të gjinisë, statusit martesor, moshës, dhe etnisë



Burimi: Korporata e Fondacionit të Mijëvjeçarit, Forca e Punës e Kosovës dhe Studimi i Përdorimit të Kohës.


Kalkulimi: Instituti GAP

% e përputhjes në kategori

■ Përputhen
■ Nuk përputhen

Në Figurën 2 shihet se dallimet në fushat e arsimit janë poashtu të mëdha. Tri fushat universitare që shoqërohen me më së shumti mospërputhje horizontale janë programe të përgjithshme (88%), shkencat ekzakte (duke përfshirë fizikën, kiminë, dhe shkencat e tokës) (76%), dhe poashtu bujqësi dhe veterinari (78%). Për krahasim, dy fushat universitare që shoqërohen me më së paku mospërputhje horizontale janë edukimi (13%) dhe shëndetësi e mirëqenie (17%). Për dallimet në bazë të fushave të arsimit mund të ketë shpjegime të ndryshme dhe një prej tyre rrjedhë si pasojë e dinamikës në tregun e punës. Kërkesa e tregut të punës për të diplomuar nga shkencat ekzakte apo bujqësi dhe veterinari mund të jetë e vogël në krahasim me të diplomuar nga edukimi apo shëndetësi dhe mirëqenie. Në bazë të deklarimeve të punëtorëve, industritë me përqindjen më të lartë të të punësuarve me mospërputhje horizontale janë këto: industria e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit (62%), ndërtimtarisë (83%), tregtisë me shumicë dhe pakicë dhe riparime automjesh dhe motoçikletash (77%), dhe shërbime tjera (69%), ndërsa me më së paku mospërputhje horizontale është arsimi (9%).

Figura 2. Përputhja e fushës së arsimit dhe profesionit të të anketuarit në bazë të fushës së arsimit dhe industrisë



Burimi: Korporata e Fondacionit të Mijëvjeçarit Forca e Punës e Kosovës dhe Studimi i Përdorimit të Kohës.

Kalkulimi: Instituti GAP

Tutje, në Figurën A1.⁶ poashtu shihet se 49% e të anketuarve në zona urbane hasin në mospërputhje horizontale për dallim prej 61% të atyre në zona rurale, gjë që mund të shpjegohet nga një mungesë e një laramanie profesionale në zona rurale. Në bazë të nivelit më të lartë të edukimit shihet se 90% e të anketuarve me shkollë të mesme gjimnaz kanë mospërputhje horizontale, në vazhdimësi me të anketuarit me shkollë të mesme profesionale (69%), me shkollim të lartë profesional (35%), me shkollim universitar (22%), dhe të anketuarit me studime Master dhe pas-universitare (11%). Në Figurën A2.⁷ shihet se dallimet e mospërputhjes horizontale

6 Shih Aneks 1

7 Shih Aneks 1

në bazë të sektorit paraqesin një strukturë të fragmentuar, ku 25% e të anketuarve në sektor publik kanë mospërputhje horizontale, 32% në ndërmarrje shtetërore, 74% në sektor privat, 63% në organizata ndërkombëtare, 47% në organizata jo-qeveritare, jo-fitimprurëse, apo humanitare, të vetëpunësuarit 59% dhe individ të tjerë privat 86%. Së fundi, kohëzgjatja e orarit ditor të punës tregon se 53% e të anketuarve që punojnë me orar të plotë kanë mospërputhje horizontale për dallim prej 74% e të anketuarve që kanë orar të pjesshëm.

Çfarë përcakton mospërputhjen në mes arsimit dhe profesionit?

Tabela A2 (shih në Aneks 3) shërben për të identifikuar përcaktuesit më të rëndësishëm të mospërputhjes horizontale. Kjo pjesë synon t'i përgjigjet pyetjes se çka shkakton mospërputhjen në mes fushës së arsimit dhe profesionit të një individi.⁸

Sipas kësaj analize, Instituti GAP gjen se gjinia përcakton një probabilitet më të ulët për mospërputhje në mes të fushës së arsimit dhe profesionit kur individi është grua. Kjo nënkupton që gratë kryesisht punojnë punë të cilat iu përshtaten fushës së arsimit të tyre më shumë se sa burrat. Megjithatë, ky dallim pozitiv për gratë në përgjithësi dobësohet për ato që kanë ndjekur fusha arsimore si drejtësi apo inxhinieri, dhe që punojnë në industri si bujqësi, prodhim, dhe tregti me shumice e pakicë. Andaj, edhe pse gratë në përgjithësi vuajnë më pak nga mospërputhja horizontale se burrat, në industri të caktuara hasin më shumë probleme se ata. Ky rezultat mund të shpjegohet nga kriteret e larta që mund të hasin gratë gjatë kërkimit të një pune qoftë të përshtatshme apo të papërshtatshme, gjë që mund të çojë në pjesëmarrje më të ultë të grave në treg të punës në përgjithësi. Përderisa, për burrat kriteret e punësimit mund të jenë më tolerues, gjë që do t'i mundësonte gjetje pune më lehtë se sa gratë në përgjithësi. Indikator i moshës tregon se individët mbi 45 vjet kanë kryesisht mospërputhje horizontale më të vogël se sa individët më të rinj, gjë që është normale për shkak se për individët më të moshuar ka pritje më të mëdha që të punojnë në industri të përputhshme me fushën e tyre të arsimit. Përcaktues i rëndësishëm i mospërputhjes horizontale është vendbanimi i individëve që tregon se nëse ata banojnë në një zonë rurale do të ketë më shumë mospërputhje se ata në zona urbane. Ky studim tregon se statusi martesor është me rëndësi të vogël për mospërputhjen horizontale, dhe se etnia e individëve nuk është fare përcaktues i asaj.

Kjo analizë poashtu paraqet fushën dhe nivelin e arsimit si përcaktues tejet të rëndësishëm të mospërputhjes horizontale. Nëse individët përfundojnë studimet në fusha të caktuara si për shembull: inxhinieri, prodhim dhe ndërtim, shëndetësi dhe mirëqenie, zanate dhe tregti, apo administratë në krahasim me shkenca shoqërore do të kenë një probabilitet më të lartë që industria t'u përshtatet me fushë të arsimit. Megjithatë për gratë në inxhinieri ai probabilitet bie. Për dallim, nëse individët përfundojnë arsimimin në fusha si programe të përgjithshme, apo bujqësi dhe veterinar, probabiliteti për përputhshmëri me fushë profesionale bie, dhe këto efekte janë poashtu statistikisht të rëndësishme. Kjo dukuri mund të paraqet problem edhe në të ardhmen nëse numri i të diplomuarve në programe si bujqësi apo ato të përgjithshme vazhdon të rritet pa ndonjë rritje të njëkohshme të vendeve të punës në sektorë shoqërore. Niveli i arsimit poashtu tregon rëndësi statistikore ku secili nivel i përfunduar që është më i lartë se shkolla e mesme apo gjimnazi do të qojë në një probabilitet më të lartë të përputhshmërisë së fushës së arsimit dhe profesionit.

8 Duhet të vihet re se për shkak të llojit të indikatorëve kategorik, nga secili indikator i tillë e marrim nga një kategori si bazë krahasuese të paraqitur në Tabelën A2.

Analiza tregon rëndësi statistikore edhe për indikatorë në lidhje me industrinë ku individët punojnë. Ngjashëm me fushën e arsimit, nëse individët punojnë në industri apo sektorë të caktuar, atëherë ajo do të përcaktojë mospërputhjen horizontale. Nëse marrim individë të punësuar nga një sërë fusha të caktuara si për shembull: në prodhim, furnizim me ujë dhe menaxhim ujërash, ndërtimtari, tregti me shumicë dhe pakicë, transport, aktivitete akomodimi, aktivitete me prona të paluajtshme dhe aktivitete administrative, administratë publike, art, dhe shërbime tjera në krahasim me industrinë e arsimit do të kenë një probabilitet më të ulët për përputhshmëri të fushës së arsimit dhe industrisë së profesionit ku individët punojnë. Për gratë në industrinë e prodhimit dhe në tregti me shumicë e pakicë ky probabilitet është edhe më i lartë. Për më tepër, kur i krahasojmë këto industri me atë të arsimit nuk ka ndonjë fushë që rritë probabilitetin për përputhshmëri horizontale. Përveç problemit sipërfaqësor të ekzistencës së mospërputhjes horizontale në një sërë industrishë profesionale, mospërputhja vetë-përjetësohet për shkak të kostos së lartë individuale të ndërrimit të punës dhe mungesës së trajnimeve jashtë-universitare me qëllim ri-aftësimi dhe ri-aktualizimi profesional.

Sektori i punës poashtu luan rol në përcaktimin e mospërputhjes horizontale duke na treguar se kur i krahasojmë individët që punojnë në sektorin privat, organizata ndërkombëtare, organizata jo-qeveritare jo-fitimprurëse dhe ato fitimprurëse, dhe individ tjerë privat me individët në sektorin publik, atyre iu bie probabiliteti për përputhshmëri horizontale. Sa i përket kohëzgjatjes së orarit ditor të një pune, individët që punojnë me orar të pjesshëm për dallim prej atyre me orar të plotë iu bie probabiliteti që të kenë përputhshmëri. Përcaktuesit nga ana e industrisë vijnë si pasojë e dinamikave komplekse të tregut të punës që mund të paraqesin kërkesë më të lartë për punëtorë të fushave të caktuara, dhe nga punësimi që punëdhënësit mund të ofrojnë edhe për punëtorë që nuk kanë përputhshmëri të fushës të arsimit dhe llojit të punës domosdoshmërisht.

Dallimet gjinore në arsim dhe profesione

Analiza e mospërputhjes horizontale tek popullsia e Kosovës në bazë të të dhënave nga Korporata e Fondacionit të Mijëvjeçarit tregon ndër të tjera se mospërputhja e fushës së arsimit dhe profesionit është më e vogël te gratë se te burrat në përgjithësi, por jo në të gjitha rastet. Në disa industri të caktuara probabiliteti për mospërputhje horizontale te gratë rritet tejte shumë. Prandaj, Instituti GAP poashtu hulumton pjesëmarrjen e burrave dhe grave në industri të caktuara në Kosovë.

Vlerësimet demografike tregojnë se dy të tretat e popullsisë janë fuqi punëtore aktive. Të dhënat e vitit 2019 tregojnë se punësimi është me i lartë te burrat (46%), ndërsa më i ultë te gratë (14%).⁹ Kjo disbalancë është parashikuar se do të thellohet në vitet në vijim (2021-2051), me ç'rast potenciali ekonomik i grave në vazhdimësi do të jetë tejte i pa shfrytëzuar.¹⁰

Ekonomia në Kosovë bazohet më së shumti në shërbime (rreth 30%), ku nga këto shërbime 13% bëjnë pjesë në tregti me shumicë dhe pakicë dhe riparim të automjeteve dhe motoçikletave, ndërsa 7.8% në administrata publike, mbrojtje dhe sigurim të detyrueshëm social. Në të 12 industritë që hynë në kategorinë e

⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Anketa e fuqisë punëtore 2019. Burimi: <https://bit.ly/3aYapWt>

¹⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2013) 'Parashikimi i popullsisë së Kosovës'. Burimi: <https://bit.ly/38EK7Jb>

shërbimeve, punësohen rreth 59% e burrave dhe 77% e grave krahasuar me industrinë tjetër që punësojnë më pak njerëz, por janë më produktivë.¹¹

Të dhënat nga ASK të paraqitura në Tabelën 1 tregojnë se burrat punësohen në industrinë më produktive të ekonomisë. Këto industri përfshijnë atë të furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar, të aktiviteteve financiare dhe të sigurimit, transportit, administratës publike dhe mbrojtjes, prodhimit, dhe aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike. Ndërsa, gratë në Kosovë janë më shumë të punësuara në industrinë e tregtisë me shumicë dhe pakicë, arsim, shëndetësi dhe punë sociale.¹²

Tabela 1. Punësimi me bazë gjinore gjatë vitit 2018, i renditur sipas produktivitetit më të lartë

Industritë	Produktiviteti i punës për vitin 2018	Punësimi i burrave	Punësimi i grave
Aktivitetet e pasurive të paluajtshme	€ 1,675,449	0.1%	0.0%
Miniera dhe gurore	€ 47,457	1.1%	0.1%
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	€ 42,592	4.2%	0.9%
Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	€ 35,404	2.3%	0.1%
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	€ 32,767	1.7%	3.2%
Transporti dhe ruajtja	€ 21,526	3.8%	1.5%
Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm shoqëror	€ 21,484	7.1%	6.5%
Prodhimit	€ 20,387	11.4%	6.1%
Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	€ 16,185	1.5%	2.6%
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	€ 14,590	16.8%	17.7%
Ndërtim	€ 13,519	14.8%	1.2%
Aktivitetet e furnizimit me ujë, kanalizimeve, administrimit të mbeturinave dhe rivitalizimit të tokës	€ 11,067	1.5%	0.4%
Informacioni dhe komunikimi	€ 10,236	3.5%	3.1%
Arsim	€ 6,455	8.5%	21.8%
Shëndetin e njeriut dhe aktivitetet e punës sociale	€ 6,213	3.7%	13.4%
Art, argëtim dhe rekreacion	€ 5,868	1.5%	0.8%
Aktivitete administrative dhe mbështetëse	€ 4,489	2.9%	2.8%
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	€ 3,467	7.7%	3.6%
Aktivitete të tjera shërbimi	€ 785	4.7%	5.1%
Aktivitetet e familjeve si punëdhënës;	€ -	0.4%	6.9%

Burimi: Produktiviteti i punës në Kosovë është llogaritur duke përdorur të dhënat e ASK-së për bruto produktin vendor dhe punësimin.¹³ Të dhënat e punësimit me bazë gjinore u morën nga Anketa e Fuqisë Punëtore në ASK - Kosovë 2018.¹⁴

¹¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2018). Platforma e të dhënave. Të dhënat e përpunuara nga Instituti GAP. Burimi: <http://bit.ly/37zyjFf>

¹² Ibid.


¹³ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Bruto Produkti Vendor (BPV). Burimi: <https://bit.ly/2v8lKTy>

¹⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). 'Anketa e Fuqisë Punëtore 2018.' Burimi: <https://bit.ly/37iQK1ë>

Dallimet gjinore vërehen edhe në përzgjedhjen e karrierës akademike të studentëve. Të dhënat tregojnë se burrat dhe gratë zgjedhin drejtimet e studimeve që indentifikohen nga stereotipet shoqërore. Për shembull, gratë kanë tendencë më të madhe të drejtohen në mjekësi apo shkenca sociale si edukimi dhe gjuhët e huaja, ndërsa burrat kryesisht zgjedhin shkenca ekzakte si inxhinieria, teknologjia apo ndërtimtaria.

Këto dallime vërehen si në universitetet publike ashtu edhe në ato private. Figura 3 tregon se rreth 87% e studentëve të regjistruar në inxhinieri mekanike janë burra, përderisa 92% e të regjistruarve në drejtimet e edukimit janë gra. Në mjekësi, 74% e studenteve janë gra, ndërkaj në fakultetin e Filozofisë dhe Filologjisë përqindja e grave të regjistruara gjatë viteve akademike 2017/2018 dhe 2018/2019 ishte 71% respektivisht 68%. Ndërsa, përjashtim interesant është fakulteti i shkencave natyrore ku rreth 61% e studentëve të regjistruar janë gra. Dallime në përzgjedhjen e fushës së edukimit reflektohen edhe në punësim.

Figura 3. Numri i studentëve të regjistruar në drejtimet përkatëse, sipas gjinisë (e shprehur me përqindje).



Burimi: Grafi i përpiluar nga Instituti GAP. Të dhënat përfshijnë numrin e studentëve të regjistruar në universitetet publike dhe kolegjet private për vitin akademik 2017/2018 dhe 2018/2019 prej Universitetit të Prishtinës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Këta tregues të fushave të arsimit dhe të industrive të profesionit theksojnë që burrat dhe gratë fokusohen në arsim dhe profesione të ndryshme. Deri sa burrat punësohen më shumë në ndërtim dhe prodhim, gratë punësohen më shumë në arsim dhe shëndet e mirëqenie. Trendi i njëjtë është edhe te fushat e arsimit, ku burrat përfundojnë studimet kryesisht në fusha si inxhinieri dhe shkenca kompjuterike, dhe gratë në fusha si edukim dhe shëndetësi. Kjo reflekton rezultatet e mospërputhjes ku shihet qartë se industria e arsimit dhe shëndetit dhe mirëqenies vuajnë më pak nga mospërputhja horizontale, gjë që lë për të kuptuar që kjo mospërputhje duhet të jetë më e vogël te gratë.

Kjo disbalancë e mospërputhjes horizontale mund të shpjegohet edhe nga faktorë shoqëror. Hulumtimet tregojnë se në Kosovë stereotipet gjinore janë të dukshme. Gratë në Kosovë mbajnë shumë më pak pozita udhëheqëse sesa burrat në sektorin publik dhe në sektorin privat, dhe janë shumë më pak të punësuar për shkak të normave sociale që i diktojnë ato të jenë bartëse kryesore të punëve të shtëpisë.¹⁵ Në fakt, arsyeja kryesore për gratë që punojnë me orar të pjesshëm është kujdesi për familjarët, ndërsa për burrat është mungesa e një pune me orar të plotë.¹⁶

Gratë në Kosovë janë të diskriminuara edhe në gjuhën e përdorur në konkurset e punës, gjë që mund t'i dekurajojë ato të aplikojnë për pozita udhëheqëse. Për të testuar dekurajimin potencial për shkak të shkrimit të konkursit në gjininë mashkullore apo femërore, në një eksperiment social janë publikuar dy konkurse pune duke kërkuar pesë praktikane, apo pesë praktikantë ku në konkursin e parë kanë aplikuar 69% gra (meqë është shkruar në gjininë femërore), ndërsa në të dytin 79% burra (meqë është shkruar në gjininë mashkullore).¹⁷

Përfundime dhe rekomandime

Mospërputhja horizontale apo fenomeni ku fusha e arsimit nuk ndërlidhet me punën që bëjnë individët paraqet një problem thelbësor në fuqinë punëtore të Kosovës. Mospërputhja horizontale dallon varësisht prej karakteristkave të individëve: demografike, arsimore, dhe profesionale. Në bazë të të dhënave të mbledhura nga anketa e Korporatës së Fondacionit të Mijëvjeçarit ky raport tregon se në Kosovë ka mospërputhje horizontale më së shumti tek burrat (61%), beqarët (70%), të rinjtë në grupmoshën 15-29 vjet (72%), dhe individët që jetojnë në zona rurale (61%). Sa i përket indikatorëve të arsimit, individët që kanë përfunduar programe të përgjithshme kane 88% mospërputhje horizontale, dhe ata me vetëm shkollë të mesme gjimnaz 90%. Individët në industrinë e ndërtimtarisë tregojnë se 83% e tyre nuk kanë përputhshmëri në mes të fushës së arsimit dhe profesionit, ata që punojnë me orar të pjesshëm 74%, dhe individët që punojnë punë private 86%.

Kjo analizë e përcaktuesve të mospërputhjes tregon se faktorët demografik si gjinia, mosha, dhe vendbanimi përcaktojnë mospërputhjen horizontale. Për më tepër, problemi i mospërputhjes poashtu rrjedhë si pasojë e dallimeve më thelbësore përbrenda industrive dhe fushave arsimore, ku gratë përballen me mospërputhje më të lartë në fusha arsimore si inxhinieri dhe drejtësi, dhe industri si bujqësi, prodhim, dhe tregti me shumicë e pakicë.

Duke parë rëndësinë ekonomike dhe sociale të përputhjes në mes të fushës së arsimit dhe profesionit, si dhe mungesën e një analize të tillë, Instituti GAP rekomandon:

- Me qëllim që të përmirësohet cilësia e analizave për tregun e punës dhe avancimi i politikave të punësimit, Agjencia e Statistikave të Kosovës të ofrojë të dhëna më të detajuara individuale që do të mundësonin analiza më të mirëfillta të fuqisë punëtore në Kosovë;

15 Instituti GAP (2017). "Diskriminimi në tregun e punës: Ndikimi i konkurseve në pabarazinë gjinore". Burimi: <http://bit.ly/3aorQQ6>

16 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2018). Anketa e Fuqisë Punëtore 2018. Burimi: <http://bit.ly/2R4Oipq>


17 Instituti GAP (2017). "Diskriminimi në tregun e punës: Ndikimi i konkurseve në pabarazinë gjinore". Burimi: <http://bit.ly/3aorQQ6>

- Ministria e Arsimit dhe universitetet apo kolegjet përkatëse të informojnë studentët e rinj për mundësitë e punësimit pas universitetit në fusha që janë të përshtatshme me fushën e tyre të arsimit;
- Në një kornizë kohore afatshkurte, universitet publike të ofrojnë trajnime pas-universitare në bazë të kërkesave që burojnë nga tregu me qëllim të përditësimit të njohurive të individëve që do të mundësonte ata të jenë më të përputhur me profesionin e tyre.
- Me qëllim për rritje të barazisë gjinore në sektorët më produktiv të ekonomisë së Kosovës dhe thyerjes së stereotipeve profesionale në tregun e punës, institucionet para-universitare të informojnë dhe mbështesin nxënësit e sidomos vajzat qysh në moshë të re që të ndjekin profesione në sektorë produktiv, dhe poashtu profesione që historikisht kanë qenë të parapara për burra respektivisht gra.

Anekset

Aneks 1.


Figura A 1. Përputhja e fushës së arsimit dhe profesionit te të anketuarit në bazë të vendbanimit dhe nivelit të edukimit



Burimi: Korporata e Fondacionit të Mijëvjeçarit Forca e Punës e Kosovës dhe Studimi i Përdorimit të Kohës.

Kalkulimi: Instituti GAP

Figura A 2. Përputhja e fushës së arsimit dhe profesionit te të anketuarit në bazë të orarit të punës dhe sektorit të punëdhënësit



Burimi: Korporata e Fondacionit të Mijëvjeçarit Forca e Punës e Kosovës dhe Studimi i Përdorimit të Kohës.

Kalkulimi: Instituti GAP

Aneks 2.

Tabela A 1. Të dhëna deskriptive mbi indikatorët e përdorur

	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)
Indikatorët	Observimet	Mesatarja	Devijimi Standard	Minimalja	Maksimalja
Mospërputhja Horizontale	5,233	0.452	0.498	0	1
Grua	5,233	1.282	0.450	1	2
Statusi Martesor	5,233	1.716	0.511	1	4
Rural	5,233	1.510	0.500	1	2
Etnia	5,233	1.168	0.752	1	11
Mosha	5,233	2.070	0.907	1	4
Fusha e Arsimit	5,233	8.524	5.221	1	18
Niveli i Arsimit	5,233	5.587	1.223	4	8
Industria	5,233	11.72	5.644	1	22
Gjysëm Orar	5,233	1.078	0.269	1	2
Sektori	5,233	2.480	1.349	1	8

Burimi: Korporata e Fondacionit të Mijëvjeçarit Forca e Punës e Kosovës dhe Studimi i Përdorimit të Kohës

Aneks 3.

Tabela A 2. Përcaktuesit e mospërputhjes horizontale

Indikatorët e Pavarur	(1) Modeli Ekonometrik	* p<0.1 ** p<0.05 *** p<0.01,
Grua	0.371*	(0.218)
Mosha (B.k. 15-29)		
45-59	0.359***	(0.0778)
Mbi 60	0.540***	(0.120)
Statusi Martesor (B.k. Beqar)		
I/e Martuar	0.113*	(0.0652)
Etnia (B.k Shqiptar)		
Rural	-0.140***	(0.0463)
Fusha e Arsimit (B.k. Sheknca Sociale)		
Programe të përgjithshme	-0.321**	(0.148)
Inxhinieri	0.245***	(0.0870)
Prodhim dhe ndërtim	0.843***	(0.172)
Bujqësi dhe veterinar	-0.450***	(0.161)
Shëndetësi dhe mirëqenie	0.738***	(0.187)
Zanate dhe tregti	0.378***	(0.0921)
Administratë dhe zyrë	0.763**	(0.355)

Indikatorët e Pavarur	(1) Modeli Ekonometrik	* p<0.1 ** p<0.05 *** p<0.01,
Fusha e Arsimit te Gratë		
Drejtësi/Juridik X Grua	-0.421*	(0.255)
Shkenca fizike (përfshirë fizikën, kiminë dhe shkencë toke) X Grua	0.447*	(0.236)
Inxhinieri X Grua	-0.792***	(0.290)
Niveli i Arsimit (B.k. Gjimnazi)		
Shkollë e mesme profesionale (3-4 vjeçar)	0.430***	(0.0894)
Arsim post-sekondar - shkollë e lartë profesionale 4-5 vite ose arsimi post-sekondar profesional 1-2 vite	0.842***	(0.127)
Universitet	1.543***	(0.0956)
Master / studime pas-universitare apo Doktoraturë	1.858***	(0.137)
Industria (B.k. Arsimi)		
Prodhim	-0.512***	(0.150)
Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	-0.693***	(0.231)
Ndërtimtari	-0.889***	(0.144)
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjeteve dhe motoçikletash	-0.559***	(0.151)
Transport dhe depozitim	-1.197***	(0.184)
Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	-0.898***	(0.161)
Aktivitete me prona të paluajtshme	-1.113*	(0.591)
Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	-0.539***	(0.194)
Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	-1.298***	(0.131)
Arti, zbavitja dhe rekreacioni	-0.619***	(0.210)
Aktivitete të shërbimeve të tjera	-0.672***	(0.137)
Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	-0.690**	(0.303)
Tjetër	-1.017***	(0.303)
Industria te Gratë		
Bujqësi, pylltari dhe peshkim X Grua	-1.777***	(0.679)
Prodhim X Grua	-0.643**	(0.293)
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjeteve dhe motoçikletash X Grua	-0.769***	(0.238)
Sektori (B.k. Qeveri, sektor publik ose në sektorin e sigurisë)		
Kompani ose ndërmarrje private	-0.632***	(0.0734)
Organizatë ndërkombëtare	-0.699***	(0.199)
OJQ, organizatë jo-fitimprurëse ose organizatë humanitare	-0.577**	(0.227)
Individ privat tjetër	-0.877***	(0.158)
Gjysëm Orar	-0.181**	(0.0912)
Konstantë	-0.276*	(0.161)
Observe		
Pseudo R-Squared	0.413	

Shënim: Gabimi standard robust (Robust standard error) në kllapa. B.k. = baza krahasuese.

Burimi: Korporata e Fondationit të Mijëvjeçarit Forca e Punës e Kosovës dhe Studimi i Përdorimit të Kohës.

Kalkulimi: Instituti GAP. Kategoritë jo-statistikisht të rëndësishme janë redaktuar me qëllim kompresimi të studimit. Indikatorit e etnisë nuk përmbanë asnjë kategori statistikisht të rëndësishme.


Instituti GAP është një think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4, 10000 Prishtinë

Tel: +383 38 609 339

info@institutigap.org



Instituti GAP mbështetet nga:



Ky projekt është mbështetur nga:



Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Institutit GAP dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

Analizë e shkurtër mbi
mospërputhjen e arsimit dhe
profesionit në Kosovë